

L I G J
Nr. 8682, datë 7.11.2000

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8405, DATË 17.9.1998 “PËR URBANISTIKËN”,
NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8501, DATË 16.6.1999**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Neni 1

Në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, ndryshuar me ligjin nr.8501, datë 16.6.1999, bëhet ky ndryshim:

Në nenin 51 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Përfshihen komunat që kryejnë investime me fondet e FZSHH-së nga pagesa e 1 për qind e vlerës së investimit sipas preventivit të objektit për llogari të financimit të studimeve urbanistike të pushtetit vendor dhe 1 për qind për rikonstruksionin e rrjeteve të infrastrukturës nga organet e pushtetit vendor.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2797, datë 17.11.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**